



CITY OF WORCESTER, MASSACHUSETTS

CITY CLERK DEPARTMENT

Susan M. Ledoux, City Clerk

Stephen A.J. Pottle, Assistant City Clerk

Niko Vangjeli, Assistant City Clerk

ALBANIAN VOTER REGISTRATION GUIDE

REGJISTRIMI I VOTUESVE KUSH KA TË DREJTË TË REGJISTROHET PËR TË VOTUAR?

Ju mund të regjistroheni ose të para regjistroheni për të votuar në shtetin e Massachusetts nëqoftëse:

- Jeni qytetar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës; dhe
- Keni mbushur 16 vjeç; dhe
- Jeni banor në shtetin Massachusetts; dhe
- Nuk jeni aktualisht i burgosur për arsye kriminale.

Nëqoftëse plotësoni kërkesat e mësipërme, ju mund të regjistroheni për të votuar në internet, me postë, ose të paraqiteni personalisht në zyrën e caktuar. Afati për t'u regjistruar për të votuar për çdo lloj zgjedhesh (lokale apo kombëtare) apo për mbledhje të rregullta të organeve të qytetit është njëzetë (20) ditë para datës së zgjedhjeve apo të mbledhjes.

SI MUND TË REGJISTROHENI PËR TË VOTUAR

Regjistrimi në Internet:

Për t'u regjistruar për të votuar në Internet, duhet të keni të depozituar firmën në Regjistrin e Automjeteve. Nëqoftëse keni patentë shoferi apo kartë identiteti të shtetit të Massachusetts, mund të përdorni aplikimin për regjistrimin si votues në internet për t'u regjistruar, ndryshuar adresën, apo për të ndryshuar anëtarësimin partiak. Dërgimi i formularit të regjistrimit të votuesit nëpërmjet internetit është i vlefshëm deri në mesnatën e ditës kur mbaron afati i regjistrimit të votuesit.

REGJISTROHUNI NË INTERNET @ www.registertovotema.com

Qytetarët e Massachusetts që nuk kanë patentë apo kartë identiteti të lëshuar nga Regjistri i Automjeteve gjithsesi kanë të drejtë të plotësojnë aplikimin në internet të cilin duhet ta printojnë, nënshkruajnë dhe postojnë ose dërgojnë dorazi në Zyrën e Zgjedhjeve të Worcester.

Regjistrimi me Postë:

Nëse nuk kualifikoheni për t'u regjistruar në Internet, ose preferoni të regjistroheni me postë, mund të shkarkoni formularin e regjistrimit të votuesit. Formulari duhet të plotësohet, nënshkruhet dhe postohet në adresën e Zyrës së Zgjedhjeve të Worcester. Zarfë me formularin e regjistrimit të votuesit të dërguar me postë duhet të jetë vulosur nga posta brenda afatit të regjistrimit të votuesit.



Room 208, City Hall ■ 455 Main Street ■ Worcester, Massachusetts 01608-1889

Telephone (508) 799-1134 ■ Fax (508) 799-1137

E-Mail: elections@worcesterma.gov



Regjistrimi duke u paraqitur personalisht:

Nëqoftëse dëshëroni të regjistroheni duke u paraqitur personalisht, shkoni në Zyrën e Zgjedhjeve të Worcester dhe regjistrohuni atje. Adresë: Room 208, City Hall, 455 Main Street, Worcester, Massachusetts 01608.

VOTUES JOAKTIV

Votuesit bëhen joaktivë në Listën e Votimit kur ata (1) nuk i përgjigjen Listimit Vjetor të Rrugës të Worcester; (2) ndryshojnë banesë brenda Qytetit dhe nuk dërgojnë ndryshimin e adresës në Zyrën e Zgjedhjeve; ose (3) largohen nga Qyteti dhe nuk regjistrohen për të votuar në qytetin ku kanë shkuar.

CDO TË THOTË KJO?

NDRYSHIMI I ADRESËS

Sa herë që ndërroni vendbanim duhet të ndryshoni adresën në regjistrimin e votuesit. Nëqoftëse ndërroni vendbanim mund të ndryshoni regjistrimin e votuesit duke plotësuar një formular të ri të regjistrimit të votuesit.

Nëqoftëse ndërroni vendbanim pas afatit të regjistrimit për të votuar në një zgjedhje shtetërore apo primary (zgjedhje të kandidatit të partisë ku bëni pjesë), duhet të prisni për ndryshimin e regjistrimit tuaj deri pas datës së zgjedhjeve apo primary, dhe të shkoni për të votuar në qendrën tuaj të mëparëshme të votimit në Massachusetts.

Ligji i shtetit ju lejon që të votoni në një zgjedhje shtetërore sipas adresës së mëparëshme deri në gjashtë muaj pasi keni ndërruar vendbanim, me kusht që të mos jeni regjistruar gjatë.

NDRYSHIMI I ADRESËS NË INTERNET @ www.registertovotema.com

PARTITË POLITIKE

Nëqoftëse dëshëroni të ndryshoni anëtarësimin në parti, mund të plotësoni një formular të ri të regjistrimit të votuesit. Anëtarët e partive politike mund të votojnë vetëm për kandidatin e partisë së tyre në zgjedhjet primary. Votuesit e paanëtarësuar në parti që zakonisht quhen “Të pavarur”, dhe anëtarët e grupimeve politike apo të partive të vogla mund të votojnë në primary për partinë që zgjedhin ata vetë. Vendimi për të votuar për një parti të caktuar në primary NUK ju regjistron si anëtarë të asaj partie.

FORMULARI I NDRYSHIMIT TË ANËTARËSIMIT @ www.registertovotema.com

KENI PYETJE?

Çfarë duhet të bëj nëse pas regjistrimit për të votuar nuk kam marrë njoftim nga zyrtari im i zgjedhjeve?

Nëqoftëse, brenda 2 apo 3 javëve nga data e regjistrimit, NUK keni marrë njoftim nga Zyra e Zgjedhjeve të Worcester për statusin tuaj si votues, ju lutemi kontaktoni Zyrën e Zgjedhjeve 508-799-1134.

